Murseli pranon se pagoi për vrasjen e gruas së tij

FOTO: Vendi ku ndodhi vrasja të mërkurën (29.11.2023)

1 dhjetor 2023, 21:44

Shpërndaje në

Bashkëshorti i viktimës L.M., i dyshuari Naim Murseli, e ka pranuar para hetuesve se e ka porositur vrasjen e gruas te i dyshuari G.P.

Burime të "Betimi për Drejtësi" bëjnë të ditur se i dyshuari Murseli ia kishte dhënë të dyshuarit G.P., 15 mijë euro para vrasjes, e 15 mijë të tjera do t'ia jepte pas kryerjes së veprës.

Dy të dyshuarit për vrasjen e ndodhur të mërkurën, i cili rast fillimisht u cilësua si "Grabitje me pasoja të vrasjes", janë dërguar në mbajtje për 48 orë.

Lajmin e ka konfirmuar për "Betimi për Drejtësi", prokurorja Besa Limani, e cila tha se pas intervistimit, dy të dyshuarit janë dërguar në mbajtje.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më herët njoftoi se janë realizuar bastisje në dy lokacione në Gjakovë, ku u arrestuan të dyshuarit, si është sekuestruar arma e cila dyshohet të jetë përdorur për kryerjen e veprës penale.

"Sipas udhëzimeve së Prokurorit të Shtetit dhe me aprovim të gjyqtarit të procedurës paraprake, Njësisi i Hetimeve të Përgjithshme të Prishtinës, në kuadër të Policisë së Kosovës, kanë realizuar bastisje në dy lokacione në Gjakovë, me ç' rast nga ky aksion janë arrestuar personat G.P.(dorasi) dhe N.M. (bashkëshorti i viktimës), të dyshuar në vrasjen e viktimës, si dhe është sekuestruar arma e cila dyshohet të jetë përdorur në këtë rast", thuhet më tej.

Prokuroria njoftoi se në koordinim me policinë po vazhdon me ndërmarrjen e veprimeve hetimore lidhur me këtë rast.

Burimet e KOHËS bëjnë të ditur se i dyshuari G.P., e ka pranuar para prokurores se është Murseli ai që e ka paguar ta kryejë vrasjen.

KOHA është interesuar të marrë vesh se nga kush përfaqësohet Murseli në prokurori e polici. Deri tash, s'ka marrë informacion.

Arrestohet edhe i dyshuari i tretë, pjesëtar i FSK-së, për vrasjen e gruas në Prishtinë
Është arrestuar edhe i dyshuari i tretë që ka lidhje me vrasjen e Liridona Murselit të...
Koha.net | Dec 1

Me billboard në Sllatinë, Trumpit i uroi shërim të shpejtë
Një shtetas kosovar ka paguar një pano reklamuese në Sllatinë, me të cilën i ka uruar...
Koha.net | Oct 6, 2020

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Taboola Feed

Pllakat e reja të murit prej gome nuk kërkojnë instalim (Kërko këtu për pllaka)
Pllaka muri gome | Kërko reklama | Sponsored

Disa keshilla ne lidhje me Psoriasis
Blog | Sponsored
Lexo me shumë

Mbani në kontroll Psoriasis dhe Egzemën në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo me shumë

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo me shumë

Fertility Clinics Might Be Better Than You Think
Sponsored Listings | Sponsored

People from Albania Might Not Believe Used Car Prices
Used Cars | Search | Sponsored

Qetësoni dhimbjen e kockave dhe të muskujve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo me shumë

31 Hilarious T-Shirt That Went Viral Because They Were So Funny!
Luxurywatch.com | Sponsored

Albania Prices of Unsold Laptops Might Suripse You
Unsold Laptops | Search Ads | Sponsored

Ja disa keshilla në lidhje me dhimbjen e kockave
Blog | Sponsored
Lexo me shumë

The Price of A Home Security Camera May Surprise You!
Surveillance Cameras - Search Ads | Sponsored

Unsold Emergency Generators Now Almost Being Given Away
Emergency Generators | Sponsored
Learn More

24 orë të rënda në Prishtinë, dyshohet se dy persona u vranë e një u vetëvra
Koha.net

Vrasja që tronditi vendin
Koha.net

TË TJERA

I mituri theret me thikë në Fushë-Kosovë

Një muaj paraburgim të dyshuarve për grabitje në Suharekë

Shpërthim me mjet piroteknik në Mitrovicë të Veriut

Arrestohet edhe i dyshuari i tretë, pjesëtar i FSK-së, për vrasjen e gruas në Prishtinë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i pasaktësuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfardolloi mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe internetit a mediumi tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeljet e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të kenë gabime!